



Datë: 18.09.2025
Numër Protokolli: 6629/2025

A.nr.1532/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1532/2025 të datës 04.08.2025, të parashtruar nga ankuesi D.G, kundër organit të punësimit: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1532/2025, të datës 04.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, D.G.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, D.G (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 04.08.2024 ka parashtruar ankesë më numër protokolli 5213/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1532/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me rishikimin e çështjes për rikthimin e tij në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, ***sepse:***

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 30.04.2025, është i punësuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill, thekson se Divizioni i Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, me datë 23.07.2025 ka ftuar nëpunësit e nivelit drejtues për nënshkrimin e akt emërimeve të reja me mandat, edhe pse përkundër faktit se Akt emërimi i tij me shifër AE.Nr.10/24 i datë 15.02.2024, është me kohë të pacaktuar, dhe se mbi këtë bazë i njëjti kërkon rishikimin e çështjes për rikthimin e tij në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe dhënien e mandatit të parë, sipas nenit 79 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publik.

Nga të dhënat që posedon Këshilli, rezulton se ankuesi, me datë 02.10.2023, kishte parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër protokolli Nr.prot.2357 të Ministres së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përmes të cilit e ka shfuqizuar Akt Emërimit të datës 03.10.2016 të ankuesit, në pozitën e punës „Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit”, duke e obliguar Njësinë përgjegjëse të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme që ta bëjë sistemimin e tij, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.12.2023, ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.1237/2023, me të cilin e ka APROVUAR pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit D.G, dhe kishte udhëzuar të njëjtin për mundësin e ushtrimit të mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Andaj, duke marr për bazë faktin se objekti i kësaj ankese është i njëjtë me objektin e ankesës për të cilën, Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore, me Vendimin A.nr.1237/2023, të datës 01.12.2023, Kolegji konstatoi se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative në kuptim të dispozitave të nenit 101, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktik.*

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 101, paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1532/2025, të datës 04.08.2024, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1532/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit D.G;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.